

MSc. NIRVANA DELIU

Propozuar nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Hulumtuese politikash dhe koordinatore projekti pranë Lëvizjes Europiane në Shqipëri, e angazhuar që nga viti 2016.

Znj. Deliu është e angazhuar pranë Lëvizjes Europiane në Shqipëri (EMA) si hulumtuese politikash dhe koordinatore projektsh prej më shumë se 8 vite. Ajo ka përfunduar në 2012 studimet e saj Bachelor në Shkenca Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale në Tiranë dhe më pas, në vitin 2015, realizoi me sukses Masterin Shkencor në Teori Politike në të njëjtin universitet. Ndërkohë, ajo ka ndjekur dhe një Master Specializues në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Università Cattolica del Sacro Cuore, Milano, Itali gjatë vitit 2014.

Puna e saj te EMA është kryesisht e përqendruar në realizimin e studimeve, ku ajo është autore e disa publikimeve dhe studimeve, dhe zbatimin e projekteve për çështje që lidhen më së shumti me Kapitujt 23 dhe 24 të Acquis së BE-së si: drejtësia, anti-korrupsioni, mirëqeverisja, lufta kundër krimit të organizuar, migracioni dhe politika e vizave duke analizuar dhe monitoruar legjislacionin në këto fusha, procesin e harmonizimit të kuadrit ligjor shqiptar me atë europian dhe politikat e reformat e ndërmarra në këtë drejtim. Shumë prej projekteve që ajo koordinon kanë në fokus forcimin e kapaciteteve dhe përfshirjen e shoqërisë civile në këto fusha. Ajo është pjesë e bordit të vlerësimi pranë Revistë Juridike Shqiptare. Ajo ka punuar si pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, në Departamentin e Shkencave Politike për rreth dy vite (2018-2020).

Fushat e saj të ekspertizës përfshijnë demokracinë, mirëqeverisjen dhe shtetin e së drejtës, migracionin dhe të drejtat e njeriut, fuqizimin e shoqërisë civile dhe bashkëpunimin rajonal. Ajo flet: shqip (gjuha amtare), anglisht dhe italisht, dhe ka njohuri bazë në frëngjisht.

MSc. NIRVANA DELIU

Proposed by the European Movement in Albania (EMA)

Policy researcher and project coordinator at the European Movement in Albania, engaged since 2016.

Nirvana has been engaged with the European Movement in Albania (EMA) as a policy researcher and project coordinator for over 8 years. She completed her Bachelor's degree in Political Science at the Faculty of Social Sciences in Tirana in 2012, and later, in 2015, successfully obtained a Master's degree in Theory of Politics from the same university. Meanwhile, she pursued a Specialized Master's in International Relations at Università Cattolica del Sacro Cuore, Milan, Italy in 2014.

Her work at EMA primarily focuses on conducting studies, where she is the author of several publications and studies, and implementing projects related mainly to Chapters 23 and 24 of the EU Acquis, such as: justice, anti-corruption, good governance, the fight against organized crime, migration, and visa policy, by analyzing and monitoring legislation in these areas, the process of harmonizing the Albanian legal framework with the European one, and the reform policies undertaken in this direction. Many of the projects she coordinates focus on capacity building and the inclusion of civil society in these fields. She is part of the evaluation board of the Albanian Law Journal. She has also worked as an adjunct lecturer at the University of Tirana, Faculty of Social Sciences, in the Department of Political Science for about two years (2018-2020).

Her areas of expertise include democracy, good governance, and the rule of law, migration and human rights, empowerment of civil society, and regional cooperation. She speaks Albanian (native language), English, and Italian, and has basic knowledge of French.